



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Deliverty	31.05.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBSHK	2731/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 346/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.122/2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative të datës 26.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.714/2019 të datës 14.11.2019 të parashtuar nga ankuesi me adresë Rruga “C”, Mati I, Objekti Hoxha, Kati IV, Nr.23 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.prot:11232 të datës 18.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, në çështjen juridike “transferim i përkohshëm”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 714/2019 e datës 14.11.2019 e parashtuar nga ankuesi dhe vendosur sipas Aktgjykimit A.nr.122/2020 të datës 26.04.2021.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 05.02.2016 në pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit të Kontrolleve Teknike”, në Ministrinë e Infrastrukturës është transferuar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Ndërtim dhe Rekonstruktiv të Rrugëve” me Vendimin numër protokoll:11232 të datës 18.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës.

Ankuesi me datë 23.10.2019 nëpërmjet emailit zyrtar i është drejtuar udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë me kërkesën sqaruese nëse ai ka dhënë pëlqimin e transferit, mirëpo udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me datë 25.10.2019 i është përgjigjur ankuesit në emali me njoftimin se i njëjti nuk ka qenë në dijeni për transferimin e ankuesit e as që ka dhënë pëlqim për një transfer të tillë dhe i njëjti po ashtu është njoftuar përmes emali ditën kur është nxjerr vendimi për transfer me datë 18.10.2019.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.protokoll:1123 të datës 18.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.11.2019 ka parashtuar ankesë me numër protokollit 5377/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 18.11.2019, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Infrastrukturës. Ministria e Infrastrukturës nuk iu është përgjigjur Këshillit sipas obligimeve ligjore dhe afateve kohore. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sërish me datën 18.02.2020, nëpërmjet emailit me numër protokollit 374/2020 e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Infrastrukturës. Pas kësaj, më datë 18.02.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 16.12.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.122/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.12.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 14.11.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5377/2018 të datës 14.11.2019 të parashtuar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin numër protokollit: 11232 të datës 18.10.2019; Emailin e datës 18.10.2019 dërguar nga _____ për ankuesin dhe Sekretarin e Përgjithshëm; Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit i datës 05.02.2016; Emailin e datës 23.10.2019 dërguar nga ankuesi për _____ Emailin e datës 24.10.2019 dërguar nga ankuesi për _____; Emailin e datës 25.10.2019 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 11.11.2019 dërguar nga _____ për _____ Shpallja e rekrutimit e datës 31.10.2019; Anulimin e konkursit të datës 22.11.2018; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 18.11.2019; Përgjigjen në ankesë të datës 18.02.2020 me numër protokollit:381/2020; Përshkrimin e detyrave të punës për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2016; Organogramin e strukturës organizative të Ministrisë së Infrastrukturës; Kopjen e librit të pranimin të shkresave të datës 21.10.2019; Njoftimin online për hapjen e konkursit; Autorizimin e DASH/MAP të datës 29.10.2019; E-mailin e datës 18.02.2020 më kërkesën e përsëritur për përgjigje në ankesë drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës; Aktgjykimit me numër A.nr.122/2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative të datës 26.04.2021; Njoftim për ankuesin të datës 16.12.2019; E-mailin njoftues të datës 28.05.2021 dërguar për Këshillin nga Udhëheqësja e Njesisë së Burime Njerëzore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transporte; Vendimi nr. prot:5156 i datës 13.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë **është bërë i pamundur apo i kotë** andaj edhe mbi këtë bazë ligjore kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse:**



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe duke u bazuar në nenin 97 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku shprehimisht thuhet se: *''Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ ..''*, si dhe duke u bazuar në njoftimin përmes emaili të datës 28.05.2021 të Udhëheqëses së Njesisë së Burime Njerëzore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transporteve, përmes së cilit ka njoftuar Këshillin se Vendimi Nr.Prot:11232 i datës 18.10.2019 i Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transporteve me të cilin ishte transferuar ankuesi është shfuqizuar me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Prot:5156 të datës 13.07.2020 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, andaj më këtë rast Kolegji ka konstatuar se procedura administrative e nisur kundër Vendimit Nr.Prot:11232 të datës 18.10.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transporteve si dhe transferimi i nëpunësit civil me rastin e shfuqizimit të Vendimit Nr.Prot:11232 të datës 18.10.2019 tashmë kanë përfunduar pasi që ankuesi njëjti është kthyer në pozitën e mëparshme sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 05.02.2016 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit të Kontrolleve Teknike" në Departamentin e Inspektimit.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenit 104 ku është përcaktuar se: *''Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot''*, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji konstaton se procedura administrative e iniciuar nga ankuesi përmes ankesës me numër A.nr.714/2019 të parashtruar me datë 14.11.2019 është bërë i pamundur apo i kotë, respektivisht vendimi i goditur me ankesë është shfuqizuar dhe si i tillë nuk prodhon pasoja juridike në raport me ankuesin andaj edhe kanë pushuar arsyet ligjore që të vendoset ndryshe nga siç është vendosur në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.346/2021

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsora Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK- së;